



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 064
U. Br.

Nr. i faq. 3 Data: 04/01
Datum: 2023

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Referencë:	
Për/Za/To:	<i>Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës</i>
CC:	
Përmes/Preko/Throgh:	
Tema/Subjekat/ Subjekct:	<i>Raporti për Diskutimin Publik lidhur me gjashtë mujorin e dytë të punës së Ekzekutivit</i>

Raporti është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

Më datë 13.12.2022 është publikuar njoftimi për organizimin e takimit të dytë publik me qytetarë i Kryetarit Kadri Rahimaj për punën gjashtë (6) mujore të dytë të vitit 2022. Organizimi i takimit është bërë nga kryetari-kabineti i kryetarit dhe zyra për informim.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në Facebook:

Më datë 13.12.2022 është publikuar njoftimi për organizimin e këtij Takimi Publik që do të mbahej. Njoftimi është publikuar në Eëb-faqen e Komunës dhe në Facebookun e Komunës.

-Publikimet në uebfaqe:

Shqip:<https://kk.rks-gov.net/kamenice/ep-content/uploads/sites/17/2022/12/38923-AL.pdf>

Serbisht: <https://kk.rks-gov.net/kamenice/ep-content/uploads/sites/17/2022/12/38923-SR.pdf>

-Publikimet në Facebook:

Shqip:<https://www.facebook.com/photo/?fbid=517261357102868&set=pcb.517262067102797>

Serbisht:<https://www.facebook.com/photo/?fbid=517261353769535&set=pcb.517262067102797>

7

Më datën 27.12.2022 duke filluar nga ora 18:20 është mbajtur Takimi Publik ku është paraqitur para të pranishmëve Raporti për gjashtëmujorin e dytë të punës së Ekzekutivit, dhe të pranishëm kanë qenë rreth 100 qytetarë.

Të pranishëm kanë qenë Kryetari Kadri Rahimaj, Kabineti i Kryetarit përfshirë Drejtorët e Drejtorive, Zyrtarë Komunale, OJQ, media dhe qytetarë.

Hapja e takimit është bërë nga zëdhënësja e Komunës, Lidiona Marovca, e cila ka falënderuar të pranishmit duke thënë se tani po paraqitet puna e gjashtëmuajorit të dytë të Ekzekutivit për vitin 2022.

Kryetari Kadri Rahimaj në fillim të takimit ka falënderuar qytetarët, kuvendarët, shoqërinë civile, kabinetin qeverisës dhe të gjithë të tjerët duke thënë se së bashku janë munduar t'i realizojnë objektivat e paraqitura për vitin 2022.

Diskutimin e kemi ndarë në katër pjesë:

- 1.Realizimi i premtimeve dhe arritjet
- 2.Investimet Kapitale
3. Politikat, shërbimet dhe subvencionet
- 4.Diskutim i lirë

Realizimi i premtimeve dhe arritjet

I kemi dhënë 50 zotime ku prej tyre 20 i kemi realizuar, 10 i kemi filluar dhe 20 të tjera janë të papërfunduara.

Kemi buxhetin më të lartë në histori i cili është miratuar me të gjitha votat. Është bërë dyfishimi i Investimeve Kapitale.

Jemi komuna e parë në Kosovë për mbajtjen e më së shumti dëgjimeve buxhetore, ku janë organizuar 20 takime dhe është dhënë përgjigja në secilën kërkesë.

Kemi rritje prej 24% të hyrave buxhetore në krahasim me planifikimin. Janë bërë 150 kontrata për shlyerjen e borgjeve të këqija në vlerë totale prej 150,000 Euro.

Është bërë ulja e shpenzimeve, 12 fish më pak shpenzime në dreka dhe darka zyrtare. Jemi vlerësuar në 19 pozita më larë në transparencë nga KDI.

Kemi funksionalizuar këshillat lokale për secilën bashkësi ku janë mbajtur 6 takime për një vit.

Investimet Kapitale

Është nënshkruar Projekti më i madh turistik në histori të Kamenicës Lugu i Verdhë + Zip Line në vlerë 450,000 Euro. Kemi nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës rreth 1 milion euro për rrugë. Është investuar për Parkun Teknologjik në vlere 194,000 Euro. Është bërë renovimi i dy shkollave të mesme "Ismail Qemali" dhe "Metush Krasniqi" në vlerë 335,427 Euro. Është bërë renovimi i Qendrës për Punë Soiale 117,083 Euro. Është filluar një çerdhe e re në Kamenicë në vlere 741,013 Euro. Palestra e Sporteve në Koretin është afër përfundimit në vlerë 330,000 Euro. Penda për sistemin e ujitjes në fshatin Muçiverc në vlerë 350,000 Euro. Në bashkëpunim me Fondacionin "Jahjaga" kemi sjellur Mamografin dhe rentgenin e teknologjisë së fundit në QKMF.

Është zgjeruar ndriçimi publik për 8 km, 184 trupa në 8 lokalitete në vlerë 28.900 Euro.

Ka përfunduar rruga Egzodi në Berivojcë, rruga Stralicë-Moçar dhe Rruga e Kaqakëve tek lagja e romëve në vlerë 133,000 Euro. Kemirrugë me participim në shumë fshatra dhe lagje.

Kemi investuar në qytet dhe fshatra. Kemi bërë trotuar modern dhe shtigje për biçikleta.

Poinvestohet në Stadiumin e KF Kika në vlerë 355.000 Euro. Hogoshti po bëhet me ujësjellës në vlerë 136,000 Euro. Shipashnica e Poshtme është kyçur në ujësjellës. Në Shipashnicë të Epërme po përfundon kanalizimi i ujrave të zeza në vlerë 65,000 Euro. Inventarizimi i tokave-ndiha më e madhe për bujqit ndonjëherë. Për një vit janë investuar mbi 5 milion euro

në Kamenicë.

Politikat, shërbimet dhe subvencionet

Për herë të parë pas shumë vitesh Kamenica ka radiolog. Jemi në proces të rekrutimit të pediatri. Janë trefishuar subveconet në bujqësi. Për herë të parë subvencionohet fara e grurit për fermerët. Subvencionohet qumështi me 5 cent për litër. Kemi ndarë mekanizmin bujqësor bazuar në kërkesë. I kemi ndihmuar bletarët e vegjël. Kemi subvencionuar klubet sportive, OJQ-të, kemi subvencionuar fëmijët e porsalindur, kemi krijuar linjë të veçantë buxhetore për rininë.

Kemi instaluar SMART TV në secilën klasë të parë, dhe shumë klasa tjera. Kemi ndarë bursat më të larta për studentët. Po renovohet çerdhja "Filizat". Kemi angazhuar 6 asistent për fëmijë me nevoja të veemi angazhuar 6 asistent për fëmijë me nevoja të veçanta. 22 praktikanë kanë filluar praktikë me pagesë në bashkëpunim me UNDP-në. Është bërë binjakëzimi me Komunën e Kemal Pashës. Kemi funksionizuaer KVRL. Është hartuar rregullora për arsim, rregullorja e re per subvencione, rregullorja e re për taksa.

Pas përfundimit të diskutimit është hapur debati me qytetarë lidhur me pyetjet për punën e 6 mujorit të dytë të vitit 2022.

Në këtë diskutim ishte një kërkesë lidhur me qentë endacak.

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet/Pye tje	Njoftimi
Diskutim publik për gjashtëmujorin e dytë të 2022-ës për punën e Ekzekutivit	Zyra e Kryetarit	Rreth 100 pjesëmarrës	Shtëpia e Kulturës "Isa Kastrati" 27.12.2022	1	

Zyrtare për Diskutime Publike:
Valdete Berisha-Murina

